



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MIRËMBAJTJES SË OBJEKTEVE PUBLIKE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____. _____. 2026

PROCESVERBAL

Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE MATERIALE DHE PAJISJE TË TJERA TEKNIKE”

KODI/KODET PËRKATËSE NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 43320000-2 – Pajisje ndërtimi; 43325100-8 – Pajisje mirëmbajtëse të kopshteve.

VLERA E FONDIT LIMIT: 4 166 525 (katër milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2, shkronja “c”, si dhe nenit 78, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, Bashkia Shkodër, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, ka hartuar këtë procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje materiale dhe pajisje të tjera teknike”, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të neneve 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të neneve 26 dhe 30 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit është përcaktuar në zbatim të nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar.

Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit shërben si provë paraprake për përmbushjen nga operatori ekonomik të kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, duke zëvendësuar, në fazën e ofertimit, paraqitjen e një pjese të dokumenteve dhe vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit kryhet në
Adresa: L: “Tre Heronjtë”, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: dpmop@bashkiashkoder.gov.al

Sistemin e Prokurimit Elektronik, ndërsa verifikimi i një pjese të informacionit kryhet automatikisht përmes ndërveprimit të Sistemit të Prokurimit Elektronik me sistemet e tjera elektronike, për aq sa kjo është e zbatueshme.

Kërkesa për paraqitjen e Sigurimit të Ofertës është përcaktuar në zbatim të nenit 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar.

Sigurimi i Ofertës është një kërkesë e detyrueshme për procedurat e prokurimit të zhvilluara nga autoritetet kontraktore, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, dhe synon të garantojë angazhimin e ofertuesit për ofertën e paraqitur dhe mbrojtjen e interesave të Autoritetit Kontraktor gjatë zhvillimit të procedurës.

Vlera e Sigurimit të Ofertës përcaktohet në masën 2% të fondit limit dhe duhet të jetë e vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

Sigurimi i Ofertës garanton Autoritetin Kontraktor në rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, ndër të tjera, kur ofertuesi tërheq ofertën pas përfundimit të afatit për paraqitjen e ofertave, kur ofertuesi i shpallur fitues nuk paraqet sigurimin e kontratës ose kur refuzon nënshkrimin e kontratës së prokurimit.

Kërkesat e mësipërme janë kërkesa standarde të parashikuara nga legjislacioni dhe Dokumentet Standarde të Tenderit dhe nuk përbëjnë kritere shtesë apo kufizuese për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë

Operatori ekonomik duhet të plotësojë kërkesat për kapacitetin profesional nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Argumentimi

Kjo kërkesë është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pikat 1 dhe 2, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pikat 3 dhe 5, dhe nenit 55, pika 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në përcaktimin e kërkesave për kapacitetin profesional, Autoriteti Kontraktor ka marrë në konsideratë natyrën, objektin, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës, si dhe parimin që kriteret e kualifikimit duhet të kufizohen vetëm në kërkesat e nevojshme dhe proporcionale për garantimin e realizimit me sukses të saj.

Objekti i kësaj procedure prokurimi konsiston në furnizimin me materiale dhe pajisje të tjera teknike, përfshirë pajisje mekanike, elektrike, me bateri dhe me motor me benzinë, si dhe mjete e pajisje ndihmëse që do të përdoren nga Autoriteti Kontraktor për veprimtarinë e mirëmbajtjes së objekteve dhe hapësirave publike.

Nga natyra e mallrave dhe mënyra e realizimit të kontratës nuk rezulton e nevojshme që operatori ekonomik, për qëllime të kualifikimit profesional, të disponojë licenca profesionale të posaçme, personel të licencuar apo kërkesa të tjera shtesë të kësaj natyre, përtej kërkesave që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi dhe Dokumentet Standarde të Tenderit.

Për këtë arsye, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vendosja e kriterëve shtesë për kapacitetin profesional, pasi kërkesa të tilla nuk do të kishin një lidhje të drejtpërdrejtë dhe proporcionale me objektin e kontratës dhe mund të krijojnë kufizime të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Mosvendosja e kërkesave shtesë për kapacitetin profesional është gjithashtu në përputhje me natyrën e procedurës së hapur të thjeshtuar, për të cilën legjislacioni i prokurimit publik kërkon mbajtjen në konsideratë të kriterëve të thjeshtuara të pranimit, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar xhiro vjetore gjatë 3 (tre) viteve të fundit financiare, përkatësisht **2023, 2024 dhe 2025**, ku vlera e xhiros në të paktën 1 (një) nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e ulët se **1 666 610 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekë**, që përfaqëson **40% të vlerës së fondit limit**.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale të xhiros së kërkuar në të paktën 1 (një) vit të periudhës së mësipërme.

Për operatorët ekonomikë që kanë filluar ushtrimin e aktivitetit gjatë periudhës së mësipërme, vlerësimi bëhet mbi bazën e të dhënave financiare të disponueshme për periudhën e ushtrimit të aktivitetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi, me kusht që vlera minimale e xhiros së kërkuar të jetë arritur në të paktën një vit financiar.

Argumentimi

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 43, pikat 1, 2, shkronja “c”, 3 dhe 6, dhe nenit 55, pika 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 77, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020, autoritetet kontraktore mund të vendosin kërkesa lidhur me gjendjen ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë, me qëllim garantimin se këta të fundit disponojnë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për zbatimin me sukses të kontratës.

Në zbatim të nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, për provimin e kapaciteteve ekonomike dhe financiare mund të kërkojë xhiroja vjetore e realizuar për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, vlera minimale e xhiros së kërkuar nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, ndërsa kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Gjithashtu, referuar nenit 55, pika 4, të VKM nr. 285/2021, për procedurën e hapur të thjeshtuar Autoriteti Kontraktor duhet të mbajë në konsideratë përcaktimin e kriterëve të thjeshtuara të pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Në këtë lloj procedure, kërkesat ekonomike dhe financiare duhet të jenë në raport me objektin e prokurimit dhe plotësimi i tyre realizohet nëpërmjet xhiros vjetore, e cila nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës.

Në rastin konkret, fondi limit i procedurës është **4 166 525 lekë pa TVSH** dhe vlera minimale e xhiros është përcaktuar në masën **40% të fondit limit**, konkretisht **1 666 610 lekë**.

Përcaktimi i kësaj vlere është bërë duke marrë në konsideratë natyrën dhe përbërjen e objektit të kontratës, i cili përfshin furnizimin e një game të gjerë materialesh dhe pajisjesh teknike për përdorim profesional, ndër të cilat pajisje me motor me benzinë, pajisje elektrike dhe me bateri, pajisje për punime ndërtimi dhe mirëmbajtjeje, si dhe pajisje për mirëmbajtjen e hapësirave publike.

Shumëllojshmëria e mallrave që duhet të sigurohen dhe të furnizohen në kuadër të së njëjtës kontratë kërkon që operatori ekonomik të disponojë një kapacitet ekonomik dhe financiar të përshtatshëm për të garantuar realizimin e furnizimit në përputhje me sasitë, specifikimet teknike dhe kushtet kontraktore të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Në këto kushte, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për një xhiro minimale në masën 40% të fondit limit është e lidhur me natyrën dhe vlerën e kontratës, është brenda kufirit maksimal të parashikuar nga legjislacioni për procedurën e hapur të thjeshtuar dhe është e mjaftueshme për të krijuar një nivel të arsyeshëm sigurie lidhur me aftësinë ekonomike të ofertuesit për realizimin e kontratës, pa kërkuar kapacitete financiare që tejkalojnë nevojat reale të saj.

Përcaktimi i periudhës prej 3 (tre) viteve financiare, konkretisht 2023, 2024 dhe 2025, synon të mundësojë vlerësimin e kapacitetit ekonomik të operatorit mbi bazën e të dhënave financiare të përfunduara dhe të verifikueshme.

Fakti që kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale të xhiros në të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar shmanjë kufizimin e panevojshëm të pjesëmarrjes, mundëson pjesëmarrjen edhe të operatorëve ekonomikë me histori më të shkurtër aktiviteti, kur plotësojnë nivelin minimal të kërkuar, dhe është në përputhje me parimet e proporcionalitetit, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë përmbushur detyrimet për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2025, si dhe këstet e maturuara të vitit 2026, për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitet, sipas të dhënave të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me afatet e pagesës të përcaktuara nga secila njësi e vetëqeverisjes vendore.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 76, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga njësitë përkatëse të vetëqeverisjes vendore për përcaktimin e afateve të pagesës së taksave dhe tarifave vendore.

Referuar nenit 76, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përmbushja e detyrimeve për pagesën e taksave përbën një kërkesë ligjore që duhet të plotësohet nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, duke u respektuar në çdo rast kushtet dhe rastet përjashtimore të përcaktuara në këtë dispozitë.

Kërkesa për përmbushjen e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore është përcaktuar për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitet, sipas të dhënave të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), me qëllim verifikimin e rregullsisë së tij në përmbushjen e detyrimeve fiskale vendore.

Përcaktimi i detyrimeve për vitin 2025, si dhe i kësteve të maturuara të vitit 2026, është bërë duke marrë në konsideratë faktin se afatet e pagesës së taksave dhe tarifave vendore përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e miratuara nga secila njësi e

Adresa: L: “Tre Heronjtë”, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: dpmop@bashkiashkoder.gov.al

vetëqeverisjes vendore. Për këtë arsye, kërkesa kufizohet vetëm në detyrimet për të cilat ka përfunduar afati ligjor i pagesës dhe nuk përfshin detyrime apo këste të vitit 2026 që nuk janë maturuar ende në datën e zhvillimit të procedurës.

Kriteri zbatohet në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe synon verifikimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore për taksat dhe tarifatat vendore, pa krijuar kërkesa përtej detyrimeve të maturuara sipas legjislacionit në fuqi.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar furnizime të mëparshme të ngjashme, në një vlerë totale jo më të vogël se **833 305 (tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e pesë) lekë pa TVSH**, që përfaqëson **20% të vlerës së fondit limit**, të realizuara gjatë **3 (tre) viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për plotësimin e këtij kriteri, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me një ent publik, si dëshmi për përvojën e mëparshme pranohen **vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës**, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës, **ose fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen **vetëm fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pikat 3 dhe 4, dhe nenit 55, pika 4, shkronja “b”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kriteret e kualifikimit duhet të jenë të përshtatshme për të garantuar që operatori ekonomik disponon kapacitetet teknike dhe profesionale të nevojshme për realizimin e kontratës dhe duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e saj.

Referuar nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, për të provuar përvojën e mëparshme në kontratat e mallrave, Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Duke qenë se procedura e prokurimit zhvillohet sipas llojit “**Procedurë e hapur e thjeshtuar**”, Autoriteti Kontraktor ka marrë në konsideratë parashikimin specifik të nenit 55, pika 4, shkronja “b”, të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar, sipas të cilit, për kontratat e mallrave dhe shërbimeve, vlera totale e kërkuar për përvojën e ngjashme në këtë lloj procedure nuk duhet të jetë më e madhe se **20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës** dhe duhet të jetë realizuar gjatë **3 (tre) viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për këtë arsye, referuar fondit limit prej **4 166 525 (katër milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e njëzet e pesë) lekë pa TVSH**, vlera minimale e furnizimeve të ngjashme është përcaktuar në masën **20% të fondit limit**, konkretisht **833,305 (tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e pesë) lekë pa TVSH**.

Kërkesa për përvojën e mëparshme synon të verifikojë se operatori ekonomik ka realizuar më parë furnizime të ngjashme dhe disponon përvojën teknike, organizative dhe tregtare të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përcaktimi i periudhës prej **3 (tre) viteve të fundit**, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe synon që përvoja e paraqitur nga operatori ekonomik të jetë aktuale dhe e verifikueshme.

Dokumentacioni i kërkuar për provimin e përvojës së mëparshme është përcaktuar në përputhje me nenin 40, pika 4, të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar, duke bërë dallimin ndërmjet furnizimeve të realizuara me entet publike dhe atyre të realizuara me sektorin privat.

Kriteri është në përpjesëtim të drejtë me natyrën, objektin dhe vlerën e kontratës dhe është përcaktuar duke marrë në konsideratë kërkesën për kritere të thjeshtuara pranimi në procedurën e hapur të thjeshtuar, me qëllim garantimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogë teknikë, fragmente katalogësh, skeda teknike (datasheet) ose dokumentacion tjetër teknik zyrtar të prodhuesit, për artikujt e mëposhtëm:

1. Gjenerator me benzinë;
2. Prerëse asfalti;
3. Helikopter betoni;
4. Ngjeshës me benzinë para-mbrapa;
5. Prerëse betoni me akumulator;
6. Prerëse bari me motor në shpinë;
7. Kositëse bari me benzinë, me vetëlëvizje;
8. Pompë zhytëse për ujëra të pista;
9. Betonierë elektrike;
10. Skelë alumini;
11. Kamerë termike profesionale;
12. Trapan kollone;
13. Zmeriluese muri;
14. Përzierëse;
15. Pistoletë boje profesionale;
16. Matrapik për thyerje;

17. Kositëse bari elektrike me vetëlëvizje;

18. Aspirator profesional shpine me bateri.

Dokumentacioni teknik i paraqitur duhet të mundësojë **identifikimin e qartë të produktit të ofertuar dhe të prodhuesit të tij**, si dhe, kur është e aplikueshme, të evidentojë modelin, kodin ose referencën përkatëse të produktit.

Dokumentacioni teknik mund të përbëhet nga një ose më shumë dokumente zyrtare të prodhuesit, me kusht që prej tyre të mund të verifikohen karakteristikat teknike të produktit të ofertuar në raport me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Karakteristikat teknike të pasqyruara në dokumentacionin e paraqitur duhet të jenë në përputhje me kërkesat minimale të përcaktuara në specifikimet teknike të Dokumenteve të Tenderit.

Në rast se dokumentacioni teknik është në gjuhë të huaj, **pjesët e dokumentacionit që përmbajnë karakteristikat teknike të nevojshme për verifikimin e produktit të ofertuar duhet të shoqërohen me përkthim në gjuhën shqipe.**

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 6, shkronja “b”, dhe nenit 55, pika 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kërkesat për kapacitetin teknik duhet të lidhen me objektin e kontratës dhe të jenë proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e saj, me qëllim verifikimin e aftësisë së operatorit ekonomik për realizimin me sukses të kontratës.

Referuar nenit 40, pika 6, shkronja “b”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë paraqitjen e fotografive apo katalogëve teknikë si dëshmi për të provuar përmbushjen e kërkesave minimale të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit.

Në rastin konkret, dokumentacioni teknik është kërkuar vetëm për ato pajisje objekt prokurimi që kanë një numër karakteristikash teknike të matshme dhe të verifikueshme, si fuqia, tensioni, kapaciteti, dimensionet, performanca, sistemi i funksionimit, thellësia e prerjes, kapaciteti i ngarkesës, parametrat e baterisë, parametrat e motorit dhe karakteristika të tjera teknike që ndikojnë drejtpërdrejt në funksionalitetin dhe përdorimin profesional të pajisjeve.

Paraqitja e katalogëve, skedave teknike ose dokumentacionit tjetër teknik zyrtar të prodhuesit i mundëson Autoritetit Kontraktor të identifikojë produktin konkret të ofertuar dhe të kryejë një verifikim objektiv, transparent dhe të njëtrajtshëm të përputhshmërisë së tij me specifikimet teknike të kërkuara.

Kërkesa nuk është shtrirë për artikujt me karakteristika të thjeshta dhe lehtësisht të verifikueshme, për të cilët paraqitja e dokumentacionit teknik të prodhuesit nuk konsiderohet e nevojshme për vlerësimin e ofertës, konkretisht: fshesën për pllaka, shkallën e aluminit, kapësen për tapiceri, fshesën e shkurtër të kopshtarisë, fshesën rrethore të pastrimit dhe jelekun profesional për prerëse bari.

Në këtë mënyrë, kërkesa për dokumentacion teknik është kufizuar vetëm në artikujt për të cilët ky dokumentacion është i nevojshëm për verifikimin objektiv të karakteristikave të produktit të ofertuar, duke shmangur vendosjen e një barre dokumentare të panevojshme për operatorët ekonomikë.

Për rrjedhojë, kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është proporcional me natyrën e mallrave për të cilat kërkohet dhe nuk synon të kufizojë konkurrencën, por të sigurojë që produktet e ofertuara përmbushin kërkesat minimale teknike të Autoritetit Kontraktor.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë furnizimi ose autorizim, të vlefshëm për këtë procedurë prokurimi, të lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar prej tij, ku të specifikohet objekti dhe numri i referencës (REF) së procedurës, për mallrat e mëposhtme:

- **Prerëse bari me motor në shpinë me benzinë – artikulli nr. 6;**
- **Kositëse bari me benzinë, me vetëlëvizje – artikulli nr. 7.**

Në rast se deklarata e furnizimit ose autorizimi lëshohet nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion që provon marrëdhënien e autorizimit ndërmjet prodhuesit dhe distributorit.

Deklarata e furnizimit ose autorizimi duhet të përmbajë të dhëna identifikuese të prodhuesit ose distributorit të autorizuar, të mjaftueshme për verifikimin e autenticitetit të dokumentit nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pikat 3 dhe 8, dhe nenit 55, pika 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, kërkesat për kualifikim duhet të kufizohen në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që operatori ekonomik disponon aftësitë teknike dhe profesionale të nevojshme për zbatimin e kontratës dhe duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e saj.

Referuar nenit 40, pika 3, të VKM nr. 285/2021, kriteret e veçanta për kontratat e mallrave duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, ndërsa Autoriteti Kontraktor duhet të përcaktojë konkretisht dokumentacionin që kërkohet për përmbushjen e tyre. Gjithashtu, në mbështetje të nenit 40, pika 8, Autoriteti Kontraktor mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, kur i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktor ka vlerësuar të nevojshme kërkesën për deklaratë furnizimi ose autorizim vetëm për **prerësen e barit me motor në shpinë dhe kositësen e barit me benzinë me vetëlëvizje**, të cilat janë pajisje të motorizuara me karakteristika teknike të detajuara dhe përbëjnë një pjesë të rëndësishme të furnizimit, duke qenë se në preventiv janë parashikuar respektivisht **15 (pesëmbëdhjetë) copë dhe 9 (nëntë) copë**.

Kërkesa synon të krijojë siguri të arsyeshme se operatori ekonomik disponon një **burim real, të identifikueshëm dhe të verifikueshëm furnizimi** për këto pajisje dhe se, në rast shpalljeje

fitues, është në gjendje të realizojë furnizimin e sasive të kërkuara në përputhje me ofertën e paraqitur dhe kushtet e kontratës.

Kjo kërkesë nuk është vendosur për të provuar karakteristikat teknike të produkteve, pasi përputhshmëria e tyre me specifikimet teknike verifikohet nëpërmjet katalogëve, skedave teknike ose dokumentacionit tjetër teknik të prodhuesit të kërkuar në kriterin përkatës. Deklarata e furnizimit ose autorizimi ka si qëllim të provojë **mundësinë reale dhe të verifikueshme të furnizimit** të produkteve të ofertuara.

Autoriteti Kontraktor ka kufizuar kërkesën vetëm në dy artikujt e sipërcituar dhe nuk e ka shtrirë atë për të gjitha mallrat objekt prokurimi, me qëllim respektimin e parimit të proporcionalitetit dhe shmangien e vendosjes së kërkesave të panevojshme që mund të kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Pranimi i deklaratës së furnizimit ose autorizimit të lëshuar **si nga prodhuesi, ashtu edhe nga distributori i autorizuar prej tij**, mundëson pjesëmarrjen edhe të operatorëve ekonomikë që nuk janë përfaqësues ekskluzivë apo distributorë të drejtpërdrejtë të prodhuesit, por sigurojnë furnizimin nëpërmjet rrjetit të autorizuar të shpërndarjes.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kriteri është i lidhur me objektin e kontratës dhe me nevojën për të garantuar furnizimin real të pajisjeve për të cilat kërkohet, ndërkohë që kufizimi i tij vetëm në dy artikuj shmang vendosjen e një barre joproporcionale ndaj operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumentin **“Ofertë Teknike”**, sipas modelit të tabelës së përcaktuar më poshtë, për artikujt për të cilët kërkohet dokumentacion teknik sipas pikës **2.3.2** të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit.

Dokumenti **“Ofertë Teknike”** duhet të përmbajë të paktën të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i produktit	Prodhuesi	Modeli/Kodi i produktit	Emërtimi i katalogut/skedës teknike	Referenca në dokumentacionin teknik (kodi ose nr. i faqes)	Shënime
-----	----------------------	-----------	-------------------------	-------------------------------------	--	---------

Emërtimi dhe renditja e produkteve duhet të jetë sipas listës së artikujve për të cilët kërkohet dokumentacion teknik në pikën 2.3.2.

Në kolonën **“Prodhuesi”** duhet të shënohet emërtimi i prodhuesit të produktit të ofertuar.

Në kolonën **“Modeli/Kodi i produktit”** duhet të shënohet modeli, kodi ose referenca identifikuese e produktit, kur produkti disponon një të tillë.

Në kolonën **“Emërtimi i katalogut/skedës teknike”** duhet të identifikohet dokumenti teknik mbi të cilin mbështetet oferta.

Në kolonën **“Referenca në dokumentacionin teknik”** duhet të shënohet kodi i produktit ose numri i faqes/pjesës përkatëse ku gjenden karakteristikat teknike të produktit të ofertuar.

Në kolonën **“Shënime”**, operatori ekonomik mund të japë informacion shtesë ose sqarime që lidhen me identifikimin e produktit apo dokumentacionin teknik të paraqitur.

Të dhënat e pasqyruara në dokumentin **“Ofertë Teknike”** duhet të jenë në përputhje me katalogët, skedat teknike ose dokumentacionin tjetër teknik të paraqitur nga operatori ekonomik.

Mosparaqitja e dokumentit “Ofertë Teknike” ose mosplotësimi i tij në atë masë që pamundëson identifikimin e produktit të ofertuar dhe lidhjen e tij me dokumentacionin teknik përkatës, përbën mospërbushje të kriterit.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pikat 1 dhe 4, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pikat 3 dhe 6, shkronja “b”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në zbatim të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, kërkesat për kapacitetin teknik duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës dhe të kufizohen në ato kërkesa që janë të nevojshme për verifikimin e aftësisë së operatorit ekonomik dhe të përputhshmërisë së ofertës së paraqitur.

Referuar nenit 40, pika 3, të VKM nr. 285/2021, të ndryshuar, kriteret e veçanta duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me natyrën, vlerën dhe aftësinë zbatuese të kontratës, ndërsa Autoriteti Kontraktor duhet të përcaktojë konkretisht dokumentet që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë.

Gjithashtu, në zbatim të nenit 40, pika 6, shkronja “b”, të VKM nr. 285/2021, Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë paraqitjen e fotografive ose katalogëve teknikë për verifikimin e përmbushjes së kërkesave minimale teknike.

Kërkesa për paraqitjen e dokumentit “Ofertë Teknike” është vendosur me qëllim **identifikimin e qartë dhe sistematik të produkteve të ofertuara dhe krijimin e një lidhjeje të drejtpërdrejtë ndërmjet produktit konkret të ofertuar dhe katalogut, skedës teknike ose dokumentacionit tjetër teknik të paraqitur për të.**

Duke qenë se objekti i procedurës përfshin një numër të konsiderueshëm pajisjesh me karakteristika teknike të ndryshme, dokumenti “Ofertë Teknike” i mundëson Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të identifikojë në mënyrë të qartë prodhuesin, modelin ose kodin e produktit dhe referencën përkatëse në dokumentacionin teknik, duke shmangur paqartësitë gjatë procesit të verifikimit.

Kjo kërkesë **nuk detyron operatorin ekonomik të paraqesë dokumentacion teknik shtesë**, përtej atij të kërkuar në pikën 2.3.2, por vetëm kërkon sistemimin dhe referimin e informacionit teknik të paraqitur, në mënyrë që vlerësimi të kryhet në mënyrë objektive, transparente dhe të njëtrajtshme.

Kërkesa është kufizuar vetëm për artikujt për të cilët Autoriteti Kontraktor ka kërkuar katalogë, skeda teknike ose dokumentacion tjetër teknik dhe, për rrjedhojë, nuk krijon barrë dokumentare të panevojshme për mallrat e thjeshta për të cilat dokumentacioni teknik nuk është kërkuar.

Për rrjedhojë, kriteri është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe me nevojën për verifikimin objektiv të produkteve të ofertuara, është proporcional dhe nuk kufizon konkurrencën.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë **certifikatë të vlefshme ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”**, ose ekuivalente/të barasvlershme me të, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Adresa: L: “Tre Heronjtë”, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: dpmop@bashkiashkoder.gov.al

Fusha e certifikimit duhet të jetë e lidhur me tregtimin, furnizimin dhe/ose shpërndarjen e mallrave/pajisjeve teknike, profesionale, industriale ose veprimtari të tjera të ngjashme me natyrën e mallrave objekt të kësaj procedure prokurimi.

Argumentimi

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të nenit **79, pika 1**, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit **44, pikat 1, 3 dhe 4**, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Referuar nenit 44, pika 1, të VKM nr. 285/2021, Autoriteti Kontraktor, për të vërtetuar përmbushjen e kërkesave të cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve certifikata të lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit të akredituara, vetëm kur këto kërkesa janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Pikat 3 dhe 4 të të njëjtit nen kërkojnë që certifikatat të jenë proporcionale me objektin, të respektojnë parimin e mosdiskriminimit dhe të pranohen certifikata ose dokumente ekuivalente.

Kërkesa për certifikimin sipas standardit ISO 9001 është vendosur me qëllim që operatori ekonomik të provojë se disponon një **sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë** për proceset që lidhen me furnizimin, kontrollin, administrimin dhe dorëzimin e mallrave.

Objekti i kësaj procedure përfshin një gamë të gjerë pajisjesh teknike dhe profesionale, ndër të cilat pajisje mekanike, elektrike, me bateri dhe me motor me benzinë, si dhe pajisje për punime ndërtimi dhe mirëmbajtjeje. Për shkak të shumëllojshmërisë së artikujve dhe nevojës për identifikimin, sigurimin, kontrollin dhe furnizimin e tyre në përputhje me kërkesat teknike të Autoritetit Kontraktor, konsiderohet e nevojshme që operatori ekonomik të disponojë një sistem të dokumentuar të menaxhimit të cilësisë.

Certifikata ISO 9001 **nuk kërkohet për të provuar karakteristikat teknike të vetë produkteve**, pasi këto verifikohen nëpërmjet katalogëve, skedave teknike dhe dokumentacionit teknik të kërkuar në kriteret përkatëse. Ajo kërkohet për të provuar sistemin e menaxhimit të cilësisë së operatorit ekonomik në proceset që lidhen me realizimin e furnizimit.

Fusha e certifikimit nuk është kufizuar në një formulim identik me emërtimin e objektit të procedurës, por kërkohet që ajo të ketë lidhje funksionale me tregtimin, furnizimin ose shpërndarjen e mallrave dhe pajisjeve të natyrës së prokuruar, me qëllim shmangien e kufizimeve të panevojshme të konkurrencës.

Kërkesa është përcaktuar në përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës dhe nuk synon kufizimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, pasi pranohen standarde dhe dokumente ekuivalente, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Deklaratën EC/EU të Konformitetit të prodhuesit**, nga e cila të rezultojë përputhshmëria e produktit të ofertuar me rregullin/rregullat teknike të zbatueshme dhe markimi CE, për artikujt e mëposhtëm:

1. Gjenerator me benzinë;
2. Prerëse asfalti;
3. Helikopter betoni;

4. Ngjeshës me benzinë para-mbrapa;
5. Prerëse betoni me akumulator;
6. Prerëse bari me motor në shpinë;
7. Kositëse bari me benzinë, me vetëlëvizje;
8. Pompë zhytëse për ujëra të pista;
9. Betonierë elektrike;
10. Kamerë termike profesionale;
11. Trapan kollone;
12. Zmeriluese muri;
13. Përzierëse;
14. Matrapik për thyerje;
15. Kositëse bari elektrike me vetëlëvizje;
16. Aspirator profesional shpine me bateri.

Deklarata e Konformitetit duhet të jetë e lëshuar nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe të mundësojë identifikimin e qartë të produktit të ofertuar nëpërmjet emërimit, markës, modelit, kodit ose referencës përkatëse, sipas mënyrës së identifikimit të përdorur nga prodhuesi.

Në rast se një Deklaratë Konformiteti përfshin disa modele ose variante produktesh, duhet të jetë i identifikueshëm qartë modeli ose varianti konkret i ofertuar.

Në rast se dokumenti është në gjuhë të huaj, pjesët që identifikojnë produktin dhe deklarojnë përputhshmërinë e tij me rregullat/standardet teknike përkatëse duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe legjislacionit në fuqi për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore dhe rregullave teknike të zbatueshme për produktet objekt prokurimi.

Në veçanti, janë marrë në konsideratë Ligji nr. 10489, datë 15.12.2011, “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar, VKM nr. 1060, datë 23.12.2015, “Për miratimin e rregullit teknik ‘Për makineritë’ dhe përcaktimin e listës së standardeve të harmonizuara”, si dhe rregullat e tjera teknike të zbatueshme për pajisjet elektrike, elektronike dhe pajisjet për përdorim në mjedise të hapura.

Kërkesa është vendosur vetëm për pajisjet që, për shkak të natyrës dhe mënyrës së tyre të funksionimit, i nënshtrohen procedurave të vlerësimit të konformitetit dhe kërkesave përkatëse të markimit CE sipas legjislacionit teknik në fuqi.

Deklarata EC/EU e Konformitetit përbën dokumentin nëpërmjet të cilit prodhuesi deklaron se produkti përmbush kërkesat thelbësore të rregullave teknike të zbatueshme për të dhe mundëson Autoritetin Kontraktor të verifikojë ligjshmërinë e vendosjes së produktit në treg dhe përputhshmërinë e tij me kërkesat përkatëse të sigurisë.

Kërkesa nuk është shtrirë për mallrat e thjeshta ose mallrat që, sipas natyrës së tyre, nuk janë objekt i rregullave teknike që kërkojnë markim CE, duke shmangur vendosjen e dokumentacionit të panevojshëm dhe kufizimin e konkurrencës.

Për artikullin nr. 15 “Skelë alumini”, përputhshmëria me standardin EN 1004-1 ose standardin ekuivalent verifikohet nëpërmjet dokumentacionit teknik përkatës dhe nuk përfshihet në këtë kërkesë për Deklaratë EC/EU të Konformitetit.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar në mbështetje të nenit 36 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë përgatitur duke marrë në konsideratë nevojat konkrete të Autoritetit Kontraktor për furnizimin me materiale dhe pajisje të tjera teknike, të nevojshme për realizimin e veprimtarisë së mirëmbajtjes së objekteve publike dhe hapësirave në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Mirëmbajtjes së Objekteve Publike.

Objekti i prokurimit përfshin një gamë të gjerë pajisjesh dhe mjetesh për përdorim profesional, ndër të cilat pajisje me motor me benzinë, pajisje elektrike dhe me bateri, pajisje për punime ndërtimi dhe mirëmbajtjeje, pajisje për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra, si dhe pajisje e mjete të tjera ndihmëse. Preventivi përfshin 24 artikuj, ndër të cilët gjenerator, prerëse asfalti, helikopter betoni, ngjeshës, prerëse dhe kositëse bari, pompë, betonierë, skelë alumini, kamerë termike, mjete elektrike dhe aspirator profesional.

Karakteristikat teknike të përcaktuara për secilin artikull janë hartuar duke marrë në konsideratë funksionin që do të kryejë pajisja, kushtet e përdorimit, kapacitetin, performancën, sigurinë, qëndrueshmërinë dhe përshtatshmërinë për përdorim profesional, me qëllim sigurimin e mallrave që plotësojnë nevojat funksionale të Autoritetit Kontraktor.

Specifikimet teknike përbëjnë **kërkesat minimale** të Autoritetit Kontraktor. Operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ofrojnë produkte ekuivalente ose me karakteristika teknike më të mira, me kusht që produktet e ofertuara të plotësojnë funksionalitetin dhe kërkesat minimale të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit. Ky parim është parashikuar shprehimisht edhe në specifikimet teknike të hartuara për procedurën.

Për pajisjet që kanë karakteristika teknike të matshme dhe të verifikueshme dhe që, për shkak të natyrës së tyre, shoqërohen me dokumentacion teknik të prodhuesit, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar paraqitjen e katalogëve, fragmenteve të katalogëve, skedave teknike (datasheet) ose dokumentacionit tjetër teknik zyrtar të prodhuesit.

Kërkesa për dokumentacion teknik është kufizuar vetëm për artikujt për të cilët ky dokumentacion është i nevojshëm për verifikimin objektiv të parametrave të produktit të ofertuar dhe nuk është shtrirë për mallrat me karakteristika të thjeshta dhe lehtësisht të verifikueshme, për të cilat paraqitja e katalogëve ose skedave teknike nuk konsiderohet e nevojshme.

Paraqitja e dokumentacionit teknik mundëson identifikimin e produktit konkret të ofertuar dhe verifikimin në mënyrë objektive, transparente dhe të njëtrajtshme të përputhshmërisë së tij me karakteristikat minimale të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Për prerësen e barit me motor në shpinë dhe kositësen e barit me benzinë, me vetëlëvizje, Autoriteti Kontraktor ka parashikuar paraqitjen e deklaratës së furnizimit ose autorizimit nga prodhuesi apo distributori i autorizuar prej tij. Këto dy pajisje janë parashikuar respektivisht në sasinë **15 copë** dhe **9 copë**, duke përbërë një pjesë të rëndësishme të furnizimit objekt të kontratës.

Kjo kërkesë është kufizuar vetëm në këto dy pajisje dhe synon të verifikojë që operatori ekonomik disponon një burim real, të identifikueshëm dhe të verifikueshëm furnizimi për produktet e ofertuara dhe është në gjendje të sigurojë sasinë e kërkuara gjatë realizimit të kontratës. Kërkesa nuk është vendosur për të provuar karakteristikat teknike të produkteve, pasi këto verifikohen nëpërmjet dokumentacionit teknik të kërkuar në kriteret përkatëse.

Për pajisjet që, sipas legjislacionit teknik në fuqi, i nënshtrohen procedurave të vlerësimit të konformitetit dhe kërkesave për markimin CE, është parashikuar paraqitja e Deklaratës EC/EU të Konformitetit të prodhuesit, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së produktit me rregullat teknike të zbatueshme. Kjo kërkesë nuk është shtrirë për artikujt që, për shkak të natyrës së tyre, nuk janë subjekt i këtyre rregullave teknike.

Për pajisjet për të cilat në Dokumentet e Tenderit do të parashikohet periudhë garancie, kërkesa për garancinë do të zbatohet si kërkesë teknike dhe detyrim kontraktor, duke përcaktuar periudhën minimale të garancisë, fillimin e saj nga data e marrjes në dorëzim dhe detyrimin për riparimin ose zëvendësimin e pajisjes, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Specifikimet teknike janë hartuar në respektim të parimeve të transparencës, konkurrencës, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, parime të cilat janë evidentuar edhe në dokumentin teknik të procedurës.

Në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, specifikimet teknike nuk duhet të kenë për qëllim favorizimin ose eliminimin e një prodhuesi apo produkti të caktuar. Kur, për shkak të natyrës së produktit ose pamundësisë për ta përshkruar atë në mënyrë mjaftueshëm të saktë dhe të kuptueshme, është e nevojshme një referencë ndaj një standardi, tipi, marke, origjine ose karakteristike të caktuar, referenca përkatëse duhet të shoqërohet me shprehjen “**ose ekuivalente**”, duke u pranuar çdo zgjidhje që provon përmbushjen në mënyrë ekuivalente të kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Përcaktimi i specifikimeve teknike është kryer nga specialistët e fushës, mbi bazën e nevojave reale të Autoritetit Kontraktor dhe në funksion të sigurimit të mallrave cilësore, funksionale, të sigurta dhe të përshtatshme për përdorim profesional, duke respektuar parimet e proporcionalitetit, konkurrencës, trajtimit të barabartë dhe përdorimit me efektivitet të fondeve publike.